



ETIKA E BIZNESIT

Etika, koncepte bazë



MODULI 2

Moduli 2. Etika, koncepte bazë

1. Konceptet bazë për etikën në përgjithësi;
2. Gjykimet dhe llojet e tyre;
3. Standardet morale, vecorite e tyre;
4. Lidhjet midis standardeve morale dhe shoqërisë;
5. Skema e arsyetimit moral;
6. Vlerësimi i përgjegjësisë morale;
7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti i saj.

1. Etika – Koncepte bazë

- Fjala “etikë”, në përdorimin e përditshëm, ka kuptime të ndryshme.
- **parimet që drejtojnë sjelljet e një individi ose grupi të caktuar individësh”.**
 - *etikë personale;*
 - *etikë profesionale*
- Eticienët e përdorin termin “etikë” për t’iu referuar fillimisht një **studimi teorik**
 - Në analogji me shkencëtarët, të cilët përdorin për shembull termin “kimi” për t’iu referuar një studimit teorik të përkatësisë së elementëve dhe të përbërjes së tyre.

1. Etika – Koncepte bazë

- Megjithëse ka analogji në trajtim dueht thene se:
 - disiplina e etikës ndryshon shumë nga disiplinat e shkencave natyrore

- **Shkencat natyrore**

- merren me studimin fizik të objekteve, ndërsa

- **Etika trajton**

- gjykimet (vleresimet) morale qe perdoren ne procesin e marrjes të vendimeve morale.

2. Kategoritë e gjykimeve

- *Le të analizojmë këto pohime*
 - *Mona Liza është një pikturë e bukur*
 - *Zyra juaj është mobiluar me shumë shije*
 - *Shifrat e PASH janë të gabuara*

Cilat janë ato tipare të njëjta që i bashkojnë këto pohime???

- - janë pretendime (pohime) që konstatojnë apo lenë të kuptohet që diçka (apo një veprim) është i/e mirë ose :i/e keq/e, e drejtë ose e gabuar, me e mira ose me e keqa, duhet ose nuk duhet të ishte bërë.
- - shprehin vlera. - sugjerojnë (udhëzojnë) një individ që të mbajë një qëndrim të favorshëm apo të pafavorshëm ndaj një veprimi të caktuar.
- permbajnë nenkuptime lidhur me llojet e sjelljeve, me të cilat njeriu duhet të përgjigjet sipas situatave.
- shërbejnë si udhëheqese për veprim, zakonisht, ato synojnë të influencojnë mbi sjelljen njerëzore të tanishme dhe të ardhshme.
- Të gjitha këto vecori i atribuohen Gjykimeve normative

2. Kategoritë e gjykimeve

■ *Le të analizojmë pohimet e mësipërme të shprehura ndryshe:*

- *Mona Liza është një pikturë italiane*
- *Zyra juaj është e paisur me karrike dhe tavolina*
- *Shifrat e PASH nuk janë të njëjta me ato që ka audituesi i shoqërisë*

• **Cilat janë ato tipare të njëjta që i bashkojnë këto pohime???**

■ **Nuk shprehin vlera** – nuk pershkruajne (cilesojne), emertojne, perkufizojne, raportojne dhe bejne parashikime lidhur me nje veprim te caktuar.

■ Nuk synojne te pohojne qe nje veprim (sjellje) eshte i mire apo i keq, i drejte apo i gabuar.

■ Nuk lene qe te nenkuptohtet se ndaj veprimit duhet mbajtur nje qendrim i favorshem apo i pafavorshem

■ **Të gjitha këto vecori i atribuohen Gjykimeve jo-normative.**

2. Kategoritë e gjykimeve

- Në praktikë ndodh që gjykimet jo-normative të përdoren njëkohsisht edhe për të bërë gjykime normative:
 - “investimi që keni bërë ju ka shkaktuar humbje” =
 - “ju keni bërë një investim të gabuar”.
- Në raste të tjera, disa gjykime jo-normative janë të paqarta (të dykuptimta) dhe mund të interpretohen edhe si normative edhe si jo-normative.
- Për të bërë dallimin midis gjykimeve normative e jo-normative, duhet të njihim nëse pohimi (deklarimi)
 - “**pershkruan/ cileson**” në lidhje me një veprim të caktuar, apo
 - duke gjykuar për veprimin - “**keshillon**” një lloj të caktuar të sjelljes.
- **gjykimet jo-normative - pershkruese/cilesuese**
- **gjykimet normative - keshilluese**

2. Kategoritë e gjykimeve

- **Gjykimet morale**
- Etika merret me një kategori specifike të gjykimeve normative,
 - Gjykimet normative të cilat kanë lidhje me atë cka është moralisht e drejtë ose e gabuar, e mirë ose e keqe.
- Konceptet i mirë apo i keq, i drejtë apo i gabuar shpesh përdoren kundrejt pajtueshmerisë apo respektimit të disa standardeve apo kriterëve të qarta (të drejtëpërdrejta) apo edhe të nënkuptuara (p.sh. Ligjore, gramatikore, estetike, etj.
- Kur gjykojmë për një veprim të caktuar ne se ai është moralisht i drejtë apo i gabuar, i mirë apo i keq, standardet e nënkuptuara ku bazohet gjykimi janë **standardet morale**.

3. Standardet Morale

- Standardet morale perfshijne:
 - (a) norma te vecanta (specifike) morale dhe
 - (b) parime morale me te pergjitheshme.
- **Normat morale** jane standarde te sjelljes, qe kerkojne, ndalojne apo lejojne disa lloje te sjelljes.
 - **Mos lejimi i genjeshtres, vjedhjes, ofendimit**

3. Standardet Morale

- **Parimet morale**, jane standarde me te pergjitheshme të cilat perdoren per te vlerësuar mjaftueshmerine (pershtatshmerine) e politikave, institucioneve sociale dhe sjelljen individuale:
 - **Parimet e te drejtave**, nepermjet te cilave vleresohen politikat, institucionet dhe sjelljet ne raport me **mbrojtjen qe ato japin per interesat dhe lirite e individeve**;
 - **Parimet e drejtesise**, nepermjet te cilave vleresohen politikat, institucionet dhe sjelljet ne raport me **sa drejte shperndahen perfitimet dhe detyrimet** midis anetareve te nje grupi te caktuar; dhe
 - **Parimet e dobise**, nepermjet te cilave vleresohen politikat, institucionet dhe sjelljet ne raport me perfitimet neto sociale qe ato prodhojne.

3. Standardet Morale

Kur duhet te themi se nje vendim shkakton apo perfshin ceshtje etike?

... atehere kur vendimi shkel (nuk respekton) sikurse edhe kur ai është në pajtueshmëri me ndonje standard moral.

- Te thuash se nje vendim perfshin ceshtje etike nuk do te thote se vendimi eshte jo-moral (i-moral), por vetem se ekzistojne disa arsye per te shqyrtuar nga afer vendimin, ne se ai eshte ne pajtueshmeri ose jo me disa standarde morale.

3. Standardet Morale

- Nga dallojnë standardet morale prej kategorive të tjera të standardeve?
- Le të evidentojmë tiparet e SM-ve
- **Se pari** standardet morale kanë të bëjnë me veprime që janë ose ka mundësi të jenë me **pasoja serioze për mirëqenien njerëzore.**
 - norma morale e mospranimit të fiksimit të çmimeve
- **Se dyti** standardet morale **nuk mund të vendosen e as të ndryshohen me vendime të organeve të autoriteteve të vecanta**
 - Fuqia e SM lidhet me mjaftueshmërinë e arsyeve (të racionalitetit) që përdoren për të mbështetur dhe justifikuar ato, dhe për sa kohë këto arsyetime janë të mjaftueshme e të përshtatëshme, për aq kohë edhe standardet mbeten të vlefshme e të zbatueshme.

3. Standardet Morale

- **Se treti standardet morale parashikohet që te dalin përtej interesit vetiak.**
 - Individët do t`i mbeshtetin keto norma edhe ne rastin kur shkelja e tyre apo kundërvenia ndaj tyre, mund te ishte ne interesin e tyre personal dhe do të sillte përfitime individuale për ta.
- **Se katerti standardet morale bazohen ne vleresime te paaneshme (neutrale).**
 - Shumë studiues i konsiderojne standardet morale nga kendveshtrimi i nje "vezhguesi ideal" ose "nje spektatori te paanshem".
- **Se pesti standardet morale jane te lidhura me emocione te vecanta.**
 - Nëse dikush kryen një veprim që është kundër kërkesave të një standardi moral, atëhere ai do te ndihet i turpëruar, fajtor, i penduar, si edhe do të ndjejë një humbje të besimit në vetvete.

4. Lidhjet midis standardeve morale dhe shoqërisë

- Cilat janë funksionet sociale që ju shërbejnë SM?
- Anëtarët e një shoqërie bazohen në një sistem të SM-ve (**parimet e pergjitheshme etike dhe normat perkatese morale**).
 - Sistemi moral i nje shoqërie **ndalon** nje sjellje te caktuar si te gabuar (sic eshte genjeshtra ose vjedhja) dhe **pranon apo lejon** nje sjellje te caktuar (sic eshte ndihma ndaj te tjereve, mbajtja e premtimeve).
- Sistemi SM-ve i shërben disa funksioneve të rëndësishme
- **(a) Ne radhe te pare**, sistemi i SM-ve te nje shoqërie identifikon (përcakton) situatat ne te cilen cdo individ **duhet te kufizojë egoizmin e tij (interesin vetiak)** për të garantuar një sistem të sjelljes që siguron avantazhe reciproke për cilindo prej anëtarëve të shoqërisë.

4. Lidhja midis standardeve morale dhe shoqerise

- Nje shoqeri ku anëtarët:
- (1) bashkepunojne rregullisht per progresin ne funksion te perfitimeve sociale, madje edhe ne se kjo do te kerkonte lenien menjane te interesave te tyre private te castit,
- (2) e lene individin te lire te ushtroje interesat e tij baze, dhe
- (3) i ndajne perfitimet dhe detyrimet ne nje menyre "te drejte" dhe "te sinqerte" :
- do te kete shanse me te medha per te mbijetuar e prosperuar krahasuar me nje shoqeri tjeter, ku anetaret e saj veprojne ndryshe.

4. Lidhja midis standardeve morale dhe shoqerise

- Kooperimi per te arritur progresin ne funksion te perfitimeve sociale do te jape me shume te mira materiale per te gjithë.
- Cdo individ do te perfitoje nga respekti qe shoqeria tregon per interesat e tij, -
 - (te tjeret e lene te lire individin t'i ushtroje keto interesa ne paqe dhe siguri)
- **sinqeriteti dhe drejtesia** garanton stabilitetin pa te cilin shoqeria nuk mund te jetoje gjate.
- anetareve te shoqerise do t' ju sherbehet më mirë ne qofte se individët veprojne gjithmone jashte interesave të ngushta individuale (egoizmit)

4. Lidhja midis standardeve morale dhe shoqerise

- Nga sa analizuam më sipër funksioni kryesor social i SM-ve te nje shoqerie eshte udhezimi apo keshillimi i rrugeve specifike ne te cilat anetaret e nje shoqerie duhet
 - (1) te kooperojne me njeri tjetrin,
 - (2) te lene njeri tjetrin te lire, dhe
 - (3) te trajtojne njeri tjetrin ne menyre te drejte e të sinqerte.
- **rezultati** - nje sistem sjellje stabel, produktiv dhe i sigurte që siguron plotësimin më të mirë te nevojave për të gjithë individët anëtarë të shoqërisë.

4. Lidhja midis standardeve morale dhe shoqerise

- (b) Funkzioni tjetër social i SM-ve – ndihmesa që ato japin në zgjidhjen e konflikteve sociale :
- SM-të japin **justifikimeve publikisht te pranueshme per veprimet dhe politikat. (tipari i dytë i SM-ve)**
- Per te kuptuar me mire kete funksion duhet te behet dallimi midis pretendimeve (deklarimeve) **te kujdeseshme** nga pretendimet (deklarimet) **morale**.

4. Lidhja midis standardeve morale dhe shoqerise

- Pretendimet e kujdeseshme kane per qellim te kujdesen apo te mbrojnë interesin vetiak dhe mbajne parasysh vetem interesat e individeve (deshirat, nevojat, qellimet).
- pretendimet morale shkojne pertej interesave vetiake te nje individi te vecante duke synuar një mbrojtje më të gjerë.
- Ne situatat, ku individi duhet te binde te tjeret per te arritur qellimin e tij, arsyet prudente (te kujdeseshme) nuk ndihmojne shume.
- Individet mund te binden per te kooperuar vetem ne se atyre ju tregohet se veprimi qe ata duhet te kryejne mban parasysh interesat e gjithesecilit dhe jo thjesht interesat e një individi të vetëm apo të një grupi të vogël.
- SM-të permbajne gjykime qe pranohen publikisht- veprimi eshte pjese e nje sistemi sjelljeje nga i cili perfiton gjithesecili.

Permbledhje deri tani – etika koncepte bazë:

- *Etika studion nje grup te caktuar te gjykimeve normative – te cilat kane te bejne me ate cka eshte moralisht e drejte apo e gabuar e mire apo e keqe.*
- *Gjykimet per te drejtat dhe gabimet morale bazohen ne standarde qe:*
 - *(1) trajtojne perfitime apo demtime serioze humane;*
 - *(2) nuk jane formuluar nga organizma autoritative ;*
 - *(3) dalin mbi interesat vetiake ;*
 - *(4) bazohen ne vleresime apo gjykime te paanshme (neutrale) dhe*
 - *(5) shoqerohen me emocione te vecanta.*

Permbledhje deri tani – etika koncepte bazë:

Standardet morale ju sherbejne dy qellimeve bazë:

- (1) udhezimi apo keshillimi i rrugeve specifike ne te cilat anetaret e nje shoqerie duhet
 - (1) te kooperojne me njeri tjetrin,
 - (2) te lene njeri tjetrin te lire, dhe
 - (3) te trajtojne njeri tjetrin ne menyre te drejte e të sinqerte.
- (2) ndihmesa në zgjidhjen e konflikteve sociale - përmes dhenies së justifikimeve qe pranohen publikisht lidhur me veprimet apo politikat.
- Etika i studion standardet morale me qellim qe te percaktoje ne se nje gjykim moral eshte ose jo korrekt dhe te udhezoje per sjellje korrekte

5. Arsyetimi moral

■ Zhvillimet morale dhe virtuti

- Aftesite per te kuptuar dhe zbatuar standardet morale nuk lindin se bashku me njeriun.
- Aristoteli – ka argumentuar se aftesite tona morale te cilat ai i quan **virtute** ose **zakone te mira morale** zhvillohen vetem **permes trainimit dhe perseritjes**.
- Kurajo, permbajtja, zemergjeresia, vetekontroli, ndershmeria, modestia dhe pa-aneshmëria e drejtesia, jane virtute, qe sipas Aristotelit fitohen permes ketyre zakoneve.
- Megjithese zhvillimi i ketyre virtuteve kerkon kohe e perpjekje, kur ato merren (fitohen) sjellja e virtutshme behet lehtesisht dhe ne menyre te natyrshme.

5. Arsyetimi moral

Klasifikimi i disiplinave filozofike sipas Aristotelit

TEORIKE

objekti:

ndryshimin dhe jo-ndryshimin

disiplinat:

logjika, fizika, metafizika, matematika

PRAKTIKE

objekti:

veprimi drejt

disiplinat:

politika, **etika**, ekonomia

PRODHUESE

objekti:

prodhimin e sendeve në mënyrë të drejtë

Disiplinat:

estetika, retorika, shkencat teknike

5. Arsyetimi moral

Etika Filozofike:

Kërkon të influencojë direkt çështjet humane përmes vendosjes së rregullave dhe normave,

Kërkon të këshillojë qëniet humane për të vepruar në një menyrë morale të drejtë,

Kërkon arritjen e asaj cilësie që i bën veprimtaritë humane të jenë moralisht të mira,

Kërkon vendosjen e kriterëve të përgjith. që shërbejnë për të pranuar veprimt. humane si të mira në sensin moral.

5. Arsyetimi moral

Për zgjidhjen e problemeve etike përdoren dy metoda:

analitike

Etika përshkruan vlerat dhe normat që ekzistojnë në një shoqëri të caktuar në një kohe të dhënë.

Analizon vlerat dhe kërkon të japë arsyt pse ekzistojnë këto vlera në shoqëri

Investigon kodin e sjelljes që pranohet nga shumica e anëtarëve të shoqërisë.

normative

Këshillon që të veprohet moralisht drejt. Përshkruan atë çfarë duhet bërë

Kërkon vendosjen e kriterëve të përgjith. që ndihmojnë qëniet humane të vlerësojnë sjelljet dhe pikëpamjet

Etika vendos rregulla për sjelljen e drejtë morale, këto rregulla duhet të jenë të arsyeshme dhe me një bazë të shëndoshë

5. Arsyetimi moral

- **etika bashkekohore** i kushton me shume vemendje veprimit –
 - cfare **duhet** dhe cfare **nuk duhet** te bejne njerezit, edhe pse shume me teper vemendje duhet t'i kushtohet:
- **karakterit te njerezve** – pra asaj c'ka duhet te jete qenia njerezore.
- **Le të vijojmë më analizën e qënies njerëzore dhe të zhvillimit të aftësive të saj për të bërë gjykime të moralshme.**

5. Arsyetimi moral

- Fazat e zhvillimit të aftësisë njerëzore për të trajtuar dilemat etike - dhe analiza e Kohlberg-ut
- Sikurse edhe zhvillimi fizik i njeriut edhe aftësia e tij për gjykime të arsyeshme morale kalon nëpër faza të përcaktuara.
- Devotshmeria e fëmijes ndaj standarteve morale bazohet kryesisht në interes.
- Në fazën e adoleshencës, standardet morale fillojnë gradualisht të internalizohen.
- Me rritjen e mëtejshme njeriu fillon të kuptojë me qartë se ndikimi i standarteve morale dhe zbatimi i ndjekja e tyre bëhet pasi ato kanë efekt në mirëqenien e njerezve të njohur ose të atyre me të cilët individët janë të lidhur.
- Devotshmëria ndaj SM-ve në këtë fazë të zhvillimit bazohet kryesisht në besnikërinë ndaj familjes, shokëve/miqve dhe kombit.

5. Arsyetimi moral

- Rritja e aftësisë për të gjykuar, nën që standartet morale të vlerësohen në mënyrë me racionale, dhe herëp herë, kur ato nuk janë të mjaftueshme, janë të paqëndrueshme, ose paragjykojnë grupe të vecanta, të kërkohet edhe rishqyrtimi apo rishikimi i tyre.
- Moraliteti bazohet në standartet universale, të cilat në mënyrë të paanëshme mbajnë parasysh interesat e të gjithë individëve.
- Psikologu amerikan Laërence Kohlberg, mbështetur në një punë kërkimore prej me shumë se 20 vjetësh ka arritur në përfundimin se zhvillimi i aftësisë së individit për t'u marrë me çështjet morale kalon nëpër 6 faza kryesore.
 - Moral Stages and Moralization – The cognitive - development approach

5. Arsyetimi moral

■ Niveli i pare - Fazat parakonvencionale

- Ne keto dy faza femija:
 - eshte ne gjendje t'ju pergjigjet rregullave dhe parashikimeve sociale, duke mesuar dhe zbatuar per karakterin e veprimeve: "te mira", "te keqija", "te drejta" dhe "te gabuara".
 - i shikon keto rregulla si dicka që atij i imponohet nga jashte.
- Veprimet e kryera dhe arsyetimi i tyre bazohet ne interesin vetiak (egoizëm).
- **Faza e pare.** *Orientimi nga ndeshkimi dhe bindja.*
- Arsyetimi i femijes per te kryer nje veprim te drejte bazohet ne nevojen per t'i **shpetuar ndeshkimit** qe mund te vijë pas kryerjes së nje veprimi te gabuar.

5. Arsyetimi moral

- **Faza e dyte:** *Orientimi i instrumentalizuar dhe relativ.*
- «veprime te drejta» - jane vetem ato qe mund te sherbejne si instrumente per te kenaqur nevojat e femijeve apo nevojat e te tjereve per te cilët femija/jet kanë interes (dëshirë).
- femija
 - fillon te kuptoje se edhe te tjeret kane nevoja e dëshira që janë te ngjashme me ato të tij.
 - fillon të mendojë si t'i për afrojë apo nënshtrijë nevojat e tij me ato të të tjerëve, - pra fillon të kërkojë plotësimin e atyre nevojave apo dëshirave të përgjithëshme, që kanë më shumë lidhje me nevojat apo dëshirat e tij.

5. Arsyetimi moral

■ Niveli i dyte - Fazat Konvencionale

■ individi

- bëhet më social - kujdeset për të vepruar në pajtim me kërkesat familjare, të grupeve, apo të kombit, pavarësisht nga pasojat ndaj tij
- nuk është thjesht në gjendje të veprjë në pajtim me parashikimet, pasi ai shpreh besnikëri ndaj grupit dhe normave të tij.
- Mendon se anëtarët e grupit janë të ngjashëm dhe kanë kërkesa të përbashkëta
- motivohet të veprjë në përputhje me normat e grupit dhe i nënshtrohet nevojave të individëve anëtarë të grupit.

5. Arsyetimi moral

- Faza e trete: *Orientimi nga harmonia ndër- personale*
- Sjellja e mire lidhet me ate cka presin te tjeret – familja dhe shoket - per te cilet individi ndjen nevojen per besnikeri, afeksion dhe besim.
- Kryerja e nje veprimi te drejte motivohet me nevojen per te qene “nje individ i mire” ne syte e individëve apo grupeve të tjerë.

Faza e katert: *Orientimi nga Rregulli dhe Ligji.*

- **Individi:**
 - E konsideron të drejtën dhe të gabuarën duke u nisur nga këndvështrimi i besnikërisë ndaj kombit dhe vendit
 - fillon t'i shohet te tjeret si pjese te nje sistemi me te gjere social, qe percakton rolin dhe detyrimet e individeve
 - mund të bëjë dallimin midis normave qe burojne nga ky sistem nga marredheniet dhe motivet e tij nderpersonale.

5. Arsyetimi moral

- **Niveli i trete - Fazat Pas Konvencionale, Autonome, apo te Parimeve**
- **Individi**
 - nuk pranon thjesht vlerat dhe normat e grupeve të cilëve ai u përket, por:
 - **perpiqet t'i shohë situatat nga nje kendveshtrim, ku mbahen parasysh, në mënyrë të paanëshme, interesat e gjithësecilit; dhe**
 - fillon te shohë me sy kritik dhe të gjykojë edhe për ligjet qe adopton shoqeria.
 - Ligje të mira janë ato, ndaj të cilëve një individ i arsyeshëm arrin të motivohet për t'i zbatuar, pavarësisht nga pozicioni që ai zë në shoqëri dhe pavarësisht nga grupi shoqëror ku ai bën pjesë. (shembuj)

5. Arsyetimi moral

- Faza e peste: *Orientimi nga/ne kontraten sociale.*

Individi:

- shtë i vetëdijshtë për faktin që njerzit mbartin pikëpamje dhe opinione personale të ndryshme e shpesh konfliktuale, megjithatë
- e vendos theksin në gjetjen e menyrave të drejta për të arritur konsensusin, qoftë nëpërmjet marrëveshjeve, kontratave, ashtu edhe një procesi të pershtatshëm.

5. Arsyetimi moral

- **Faza e gjashte: *Orientimi ne parimet etike universale.***
Veprimet e drejta percaktohen duke u mbeshtetur ne parimet etike universale, te cilat jane zgjedhur per shkak te gjithëpërfshirjes logjike, universalitetit dhe koherencës së tyre.
- **parime etike - kane te bejne me drejtesine, mireqenien e shoqerise, barazine e qenieve njerezore dhe respektin ndaj individit.**
- **Individi kryen veprime të drejta – pasi ai angazhohet të zbatojë e parimet morale, të cilat i sheh si kritere për vlerësimin e të gjithë rregullave të tjera morale, përfshirë këtu edhe konsensusin demokratik.**

5. Arsyetimi moral

- Pavarësisht kundërshtimeve që mund të ketë, e rëndësishme është të evidentohet fakti se të gjithë bien dakord se rritja dhe zhvillimi moral kalojnë nëpër disa faza:
- Faza parakonvencionale që fokusohet në interesin vetiak,
- Faza konvencionale, ku në mënyrë të pakundërshtueshme (pa analiza e vlerësime) pranohen standardet morale konvencionale, dhe
- Faza e maturimit ku ne arrijmë të vlerësojmë me sy kritik dhe të shqyrtojmë për të reflektuar në lidhje me standardet morale konvencionale që i kemi pranuar më herët dhe të modelojmë standarde më adeguate për veten tonë.
- Studiuesit pranojnë gjithashtu, se fazat e zhvillimeve morale janë skuenciale (të vijueshme).

5. Arsyetimi moral

- Nje nga qellimet kryesore të studimit te etikes eshte zhvillimi i aftesise se individit per t'u marre me ceshtjet morale.
- Sipas teoris se Aristotelit qëllimi është të zhvillohen virtytet.
- Sipas teoris se zhvillimit sekuencial te Kohlbergut, qëllimi - t'u jape mundesi individeve qe te arrijne te kuptojne si duhet "te drejten" dhe "gabimin", qe karakterizojne fazat e mevoneshme pas-konvencionale te zhvillimit.
- Nje nga qellimet baze te studimit te etikes eshte pikërisht stimulimi i ketij zhvillimi moral.
- Një ide më e qartë mund të formohet duke parë natyrën dhe skemën e arsyetimit moral.

5. Arsyetimi moral

- Me termat “arsyetim moral” dhe “arsyetim etik” - kuptohet procesi i arsyetimit, sipas te cilit gjykohen
 - **Sjelljet e qenieve njerezore,**
 - **Sjelljet e institucioneve, apo**
 - **Politikat,**
- Qëllimi i arsyetimit moral - te jepet gjykimi nese ato (sjelljet, politikat) jane ne pajtim, apo ne kundërshtim me (shkelin) standardet morale.
- Arsyetimi moral gjithmone perfshin dy komponente esenciale:
 - Kuptimin se cfarë kerkojne apo ndalojne **standartet morale** dhe
 - **informacionin** qe tregon se nje politike e caktuar, institucion, ose sjellje permban elemente qe standardet morale kerkojne apo ndalojne.

5. Arsyetimi moral

- Komponenti i parë - Standartet morale në praktikë paraqitet tepër kompleks, pasi në SM perfshihen kritere kualifikuese, perjashtuese, kufizuese , etj..
Per te vleresuar mjaftueshmerine e arsyetimit moral eticienet perdorin kritere te te ndryshme:
- Ne radhe te pare arsyetimi duhet te jete *logjik*.
 - Analiza dhe arsyetimi moral kërkojnë që
 - logjika e argumenteve të përdorura për të vendosur për një gjykim moral, të ekzaminohet rigorozisht, dhe
 - supozimet morale e faktike të bëhen në mënyrë të qartë.

5. Arsyetimi moral

- Ne radhe te dyte evidenca faktike, që përdoret për të mbështetur gjykimin, duhet te jete e *saktë, te lidhet me gjykimin ne fjale, duhet te jetë e plotë.*
- Ne radhe te trete standardet morale qe marrin pjese ne arsyetimin moral te nje individi duhet te jene te qendrueshme (të kenë koherencë).

5. Arsyetimi moral

